



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI.**

**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Integritet Evropian**

**Mbledhja nr. 22**

**Prishtinë, më 26.06.2018, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Ilir Deda, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

**Munguan:** Ismajl Kurteshi, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti dhe Adem Hoxha.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ-i.

**Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.06.2018;
3. Shqyrtimi i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të mitur, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjaku, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-040 për Masat mbrojtëse në importe, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
9. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
10. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
11. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
12. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
13. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e trafikut Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
14. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
15. **Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.06.2018;**

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të mitur, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projekt-kod paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projekt kodi dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të mitur, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-010 për Noterinë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjaku, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjaku, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-040 për Masat mbrojtëse në importe, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, i njoftoi se ky projektligj si dhe projektligji për shërbimet postare është radhitur për seancë plenare pa raportin me rekomandim të komisionit tonë, pasi që, Komisioni ynë nuk ka arritur që ti shqyrtoi brenda afatit të paraparë ligjor. Lidhur me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-040 për Masat mbrojtëse në importe, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se Projektligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, përcakton vendosjen e rregullave për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar dhe shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përcaktimi i kushteve për qasje në rrjetin postar, nxitja e konkurrencës së lirë, përcaktimi i parimeve për tarifatat, sigurimi i transparencës së llogarive të ofrimit të shërbimit universal postar, përcaktimi i standardeve për shërbimin universal postar dhe vendosja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me këto standardeve. Legjislacioni i BE-së i transpozuar në këtë projektligj është, si vijon; Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 Dhjetor 1997, për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimit postar të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, e ndryshuar me Direktivën 2002/39/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 qershor 2002; Direktivën 2002/39/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 qershor 2002; Direktivën 2008/6/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian datë 20 Shkurt 2008.

Projektligji i propozuar nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional janë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përveç amendamenteve 2, 6, 7, 8 dhe 9.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

- 1) Projektligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
- 2) Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional janë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përveç amendamenteve 2, 6, 7, 8 dhe 9.
- 3) Komisioni për Integritet Evropian, rekomandon që, amendamentet 2, 6, 7, 8 dhe 9 të propozuara nga komisioni funksional, të mos miratohen, pasi nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

### **9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamentet e Komisionit funksional;**

**Kryetarja** në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

### **10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**11. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120, me amendamentet e Komisionit funksional;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**12. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

**13. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional;**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

#### **14. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, me amendamentet e Komisionit funksional**

**Kryetarja**, në lidhje me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, ku konstatoi se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt.

#### **15. Të ndryshme.**

##### **a) Njoftimi lidhur me tryezën e organizuar nga DCAF**

**Kryetarja**, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me një ftesë e cila ka ardhur nga DCAF lidhur me organizimin e një tryeze të rrumbullakët për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përgjimin e komunikimeve elektronike që do të mbahet me datë 5 korrik 2018.

**Ilir Deda**, tha e konsideroi si ndërhyrje flagrante të të dy Komisioneve të Kuvendit ati për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Komisionit për AKI, në punën dhe veprimtarinë e Komisionit për Integritet pas që Komisioni për Integritet Evropiane është dashur që të konsultohet paraprakisht para se të bëhet çfarëdo organizimi lidhur me këtë ligj. Shtoi, duke pas parasysh që Komisioni për Integritet Evropiane ka qenë komision funksional për këtë projektligj, propozoi që Komisioni për Integritet Evropiane të krijoj grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe tek pastaj të organizohen tryeza apo formate të tjera. Ai shtoi se nuk kanë të drejtë komisionet e tjera që të mirren me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji pasi kjo e drejtë i takon vetëm komisionit për Integritet Evropiane. Lidhur me ftesën tha personalisht nuk e shoh të arsyeshme pjesëmarrjen në këtë tryezë dhe rekomandoi që asnjë anëtar nga Komisioni ynë të mos merr pjesë në këtë tryezë për shkak të anashkalimit që është bërë nga ana e dy komisioneve në raport me Komisionin për Integritet Evropiane.

**Armend Zemaj**, tha sa i përket të drejtës së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve kjo e drejtë ju takon secilit komision parlamentar nga fushë-veprimtaria e Komisionit. Por në rastin konkret tha e shoh si të domosdoshme bashkëpunimin e Komisioneve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji pasi është një ligj shumë sensitiv dhe që ndërlidhet edhe me shumë ligje

të tjera. Propozoi që të formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit dhe të shihet shkalla e zbatimit të këtij ligji.

Kryetarja pas diskutimeve konstatoi se për shkak të seancës plenare që është planifikuar që të mbahet me datë 5 korrik 2018, është e pamundur që të marrin pjesë në këtë tryezë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

**E përgatiti :**  
**Stafi mbështetës i Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit,**  
**Blerta Deliu- Kodra**

-----